



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 119/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Zef Morina në cilësinë kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për shkak të manipulimit të votave gjatë procesit të numërimit, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Zef Morina, në cilësinë kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 31.01.2011, nga Zef Morina në cilësinë kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik LDK, me te cilën pretendon se nuk është bërë numërimi i saktë i votave me kete rast është zvogëluar numri i votave për mbi 2000 vota.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtuesi i ankesës, janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar asnjë dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Për më tepër në ankesë nuk është theksuar se ku mund të gjenden dëshmitë, nuk është ofruar asnjë hollësi apo kopje e ndonjë dokumentacioni relevant për të mbështetur pretendimet e theksuara në ankesë. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

A nr. 119/2011 më datën 02.02.2011

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muhamet Rexha**

